

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

THELLIMI EMERGJENT I BASENIT DHE KANALIT HYRËS NË PORTIN E DURRËSIT



Kategoria (Sipas Shtojcës I te Ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011):

Pika 8.

b) Portet tregtare, kalatat për ngarkim-shkarkim të lidhura me token dhe portet e jashtme (me përjashtim të kalatave të trageteve) që mund të marrin anije me mbi 1350 tone.

Zhvilluesi: Autoriteti Portual Durrës (APD)

Hartoi: Green Eagle Consulting

Erison Jmew

[Signature]



TABELA E PERMBAJTJES

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I MJEDISIT	2
1.1 MJEDISI FIZIK.....	2
1.1.1 Gjeologjia.....	2
1.1.2 Rreziku Sizmik	6
2. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I MJEDISIT BIOLOGJIK	7
2.1 MBULESA BIMORE NË VEND-ZBATIMIN E PROJEKTIT	7
2.2 BURIMET UJORE	8
3. NDIKIMET E MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDIS	8
3.1 NDIKIMET NË ORGANIZMAT DETARE	9
3.2 NDIKIMET NË CILËSINË E UJIT	9
3.2.1 Ndikimi i Turbullimit te Ujit ne gjallesat detare	9
3.3 NDOTJA AKUSTIKE	10
3.4 NDIKIMET NË TURIZËM.....	10
3.5 NDIKIMET NË TRANSPORT	10
3.6 SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS.....	10
3.7 KOHËZGJATJA E NDIKIMEVE TË IDENTIFIKUARA.....	11
3.8 SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMEVE TË MUNDSHME	11
3.9 MUNDËSIA E REHABILITIMIT.....	11
3.10 MASAT PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE.....	11
3.11 NDIKIMET NË MJEDISIN NDËRKUFITAR.....	11
4. REFERENCA.....	12

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Skema Gjeomorfologjike e bregdetit Adriatik dhe Jonian (a), dhe harta e trashesise se depozitimeve te Quatemarit ne gjirin e Durrësit (Burimi: Frasheri , 2007)

5

Figura 2: Vija Geoelektrike në zonën Durrës- Bishti i Pallës. (Burimi: Frashëri, 2007).....

7



HYRJE

Pozicioni shume i favorshëm gjeografik e bën portin e Durrësit portin me te madh ne Shqipëri dhe nder me te mëdhenjtë ne detin Adriatik dhe Jon, një nyje shume te rëndësishme për tregun ndërkombëtar. Porti i Durrësit është i pozicionuar ne pjesën jug-perëndimore te qytetit te Durrësit ne pjesën veriore te gjirit me te njëjtin emër. Infrastruktura operacionale e tij përbehet nga 11 kalata me një thellësi kalate qe varion nga 7.5m-11.5m. Mallrat kryesore qe përpunohen ne port janë mallrat e përgjithshme drithëra, kontejner, tragete, minerale etj. Porti i Durrësit ka aktualisht 78% te tregtisë detare ne nivel kombëtar. Porti i Durrësit është gjithashtu një vendndodhje kyçe për rrjetet e trageteve dhe transitin e pasagjereve, duke i dhënë Durrësit një pozicion strategjik ne lidhje me Korridorin VIII, qe do mundësojë transitin e pasagjereve dhe mallrave ne kontinentin Evropian. Kostoja e ulet operative, grupi i motivuar menaxherial dhe shërbimet cilësore janë disa nga vlerat qe karakterizojnë portin e Durrësit.

Me qëllimin e sigurimit te qëndrueshmërisë nagivacionale dhe operacionale te kanalit hyrës dhe basenit te portit te Durrësit, si një nga asetet infrastrukturore me te rëndësishme per ritjen e trafikut detar dhe te ardhurat financiare te gjeneruara nga porti, Autoriteti Portual Durrës synon te zhvilloje projektin emergjent te thellimit te basenit dhe kanalit hyrës te Portit te Durrësit. Ky projekt do te mundësonte futjen ne Portin e Durrësit te anijeve te një madhësie prej 20,000 DWT apo 1,000 TEU, si dhe ankorimin e tyre ne ane te kalatave te portit. Ato gjithashtu, do te mund te kryejnë një rrotullim te plote brenda basenit te portit, pa penguar përpunimet e anijeve te tjera te ankoruara ne kalatat përkatëse.

Bazuar ne kërkesat e **Ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011** "Për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis", projektet private apo publike, te listuara ne shtojcat I dhe II, bashkëlidhur ligjit, i nënshtrohen vlerësimit te ndikimit ne mjedis, ne përputhje me kërkesat e kreut II te këtij ligji, përpara dhënies se lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo te projektit.

Projekti i lart-përmendur (Projekti emergjent i thellimit te basenit dhe kanalit hyrës te portit te Durrësit) bën pjese ne grupin e projekteve te Shtojcës I: Projekte qe i nënshtrohen Procedurës se Thelluar te Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis, konkretisht **pika 8b**): Portet tregtare, kalatat për ngarkim-shkarkim te lidhura me token dhe portet e jashtme (me përjashtim te kalatave te trageteve) qe mund te marrin anije me mbi 1350 tone.

Struktura dhe përmbajtja e këtij dokumenti është ne përputhje me **Vendimin Nr. 686, date 29.7.2015** "Për Miratimin e Rregullave, te Përgjegjësisve e te Afateve për Zhvillimin e Procedurës se Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) dhe Procedurës se Transferimit te Vendimit te Deklaratës Mjedisore

Dokumenti përmban dy pjese:



(1) Raportin teknik te projektit te propozuar dhe (2) Informacion për Ndërveprimin me Mjedisin te Projektit dhe janë pjese e dokumentacionit te nevojshëm ne zbatim te procedurës se Thelluar te Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis për projektin e lart-përmendur.

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I MJEDISIT

Realizimi i projektit do te ketë ndikime mjedisore te cilat priten te jene minimale, te administrueshme, te përkohshme dhe me ndikim lokal, meqenëse ato janë te lidhura me një veprimtari ndërtimore (thellim te shtratit te detit) mbi një vendndodhje qe njihet tashme dhe qe është larg nga qendrat e banuara.

Ne këtë pjese synohet te behet një identifikim i efekteve negative dhe nevojës se përdorimit te lëndëve te para pozitive si edhe te propozoje marrjen e masave zbutëse duke pasur parasysh si ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit (APD) ashtu dhe shfrytëzimin racional te burimeve natyrore si dhe bashkërendimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror te zonës me kërkesat e zhvillimit te qëndrueshëm.

1.1 MJEDISI FIZIK

Porti i Durrësit ndodhet ne pjesën jugore te qytetit te Durrësit, i cili shtrihet ne gjirin e Durrësit. Koordinatat gjeografike janë: gjerësia 41° 19'N, dhe gjatësia 19°27'E. Ky është një pozicion strategjik ne mjaft aspekte:

- I gjendur ne gjirin e Durrësit, porti është i mbrojtur mire nga erërat veri-perëndimore nga kepi i Durrësit, dhe nga erërat lindore te Kepit te Lalëzit.
- Porti ka një distance mjaft te shkurtër me Italinë (rreth 200 km). dhe një lidhje direkte me portet e tjera te rëndësishme ne detin Adriatik dhe Jon. Për shkak te afërsisë se tij me kryeqytetin e Tirane, me aeroportin ndërkombëtar, dhe me zonën industriale te ndodhur ne te dy krahët e aksit Tirane - Durrës.

1.1.1 Gjeologjia

Nga investigimet qe janë bere ne Portin e Durrësit është vërejtur qe profili i përgjithshëm gjeologjik konsiston ne shtresa rërë, suargjila, argjila, torfe, lym. Ndeshen depozitimet detare (Qu dt) dhe ato te neogjenit (N2h N13).

Depozitimet e Neogjenit

Këto depozitime përbehen nga torfa, argjila dhe rëra, me një cimentim te dobët



deri mesatar te argjilave. Trashësia e Shtresës është rreth 15 - 20m. Këto formacione përfshijnë kodrën e Durrësit dhe atë te Rashbullit. Mendohet qe ndërmjet dy kodrave ka ekzistuar një kanion i cili me vone është mbushur me depozitimet detare. Depozitimet e neogjenit vijnë duke u zvogëluar nga perëndimi ne lindje. Ne anën perëndimore ato ndeshen me shtrese me trashësi rreth 10 deri 30m , ndërsa ne drejtimin lindor këto ndeshen me trashësi 80 - 100m.

Depozitimet Detare

Këto depozitime janë te përfaqësuar me argjila ne lym, argjila, lymra ranore, rëra. Depozitat janë me një ngjeshmëri te bute dhe kapërcejnë ne disa vende trashësinë 38-42m, ku depozitimet detare kane një ngjeshmëri te mire. Këto depozitime janë pothuajse uniforme. Trashësia e depozitimeve detare rritet nga perëndimi ne lindje, ku fillojnë me 10 - 30m dhe ne pjesën lindore te portit arrijnë ne 80 - 100m.

Te dhenat e Shtresave

Bazuar ne studimet e mëparshme dhe sondave gjeologjike te kryera ne vend me poshtë jepen te dhënat e shtresave qe ndeshen ne zonën e Portit te Durrësit (Figura 14).

Shtresa Nr. 1. Kjo shtrese ka material mineral dhe gurë gëlqeror dhe ne disa vende zhavorr lumi. Ne mënyrë qe te identifikohen karakteristikat e kësaj shtrese janë mare kampione ne vende te ndryshme dhe janë bere një numër provash.

Shtresa Nr. 2. Kjo shtrese është karakterizuar nga lymra ranore, me ngjyre gri te ngopura me ujë, dhe me përmbajtje materiali organik dhe pak te ngjeshura. Shtresa ndeshet ne një thellësi te madhe ose pranë mbushjes me depozitime detare. Karakteristikat fizike te kësaj shtrese janë:

Përbërja granulometrike:

Fraksioni 200:	30 - 40%
Fraksioni 40:	80 - 90%
Fraksioni 10:	90 – 100%

Përmbajtja e ujit:	$W_n = 25-30 \%$
Kufiri I rrjedhshmërisë:	$W_I = 24 - 26 \%$
Kufiri I plasticitetit:	$W_p = 19 - 21 \%$
Indeksi plasticitetit:	$I_p = 4.5 - 5 \%$



Klasifikimi

Simboli: CL - ML

Emri grupit: Lymra ranore, lymra argjilore

Pesha specifike ne gjendje te thate: 2.68 - 2.70 T/m³

Pesha volumore e ngopur me uje: 1.90 - 1.95 T/m³

Kendi ferkimit: 24 - 28⁰

Moduli Elasticitetit: $e = 0,70 - 0.80$

Shtresa Nr. 3. Kjo shtrese është karakterizuar nga Argjila lymore, ngjyre gri, me përmbajtje materiali organik i shpërndarë ne mënyrë heterogjene ne masën e argjilës, me ngjeshmëri te larte. Shtresa ndeshet nen shtresën nr.2 nga sheshi trageteve deri tek Ura e Dajlanit. Kjo shtrese vazhdon deri ne thellësinë 38m. Karakteristikat fiziko - mekanike te kësaj shtrese janë:

Përbërja granulometrike:

Fraksioni 200: 60 - 80%

Fraksioni 40: 100%

Përmbajtja e ujit: $W_n = 25 - 30\%$

Kufiri I rrjedhshmërisë: $W_I = 30 - 32\%$

Kufiri I plasticitetit: $W_p = 20 - 22\%$

Indeksi plasticitetit: $I_p = 10 - 12\%$

Klasifikimi

Simboli: CL

Emri grupit: Argjirore lymore

Pesha specifike ne gjendje te thate: 2.70 - 2.71 T/ m³

Pesha volumore e ngopur me ujë: 1.80- 1.85 T/m³

Këndi fërkimit: 14 - 16⁰

Moduli Elasticitetit: $e = 0,90 - 1.00$

Shtresa Nr. 4. Kjo shtrese është e përfaqësuar nga argjila ngjyre bezhe me pak lagështi, e forte dhe e konsoliduar. Ndeshet ne thellësinë 38 -40m me 3.5 - 4.0 m trashësi. Shume studiuës e kane quajtur këtë si formacion shkëmbor por se fundmi studiuësit e kane quajtur si normal depozitim. Karakteristikat fiziko - mekanike te kësaj shtrese janë:



Përbërja granulometrike

Fraksioni200: 65 - 85%

Fraksioni40: 100%

Përmbajtja e ujit: $W_n = 20 - 22\%$

Kufiri I rrjedhshmërisë: $W_I = 34 - 36\%$

Kufiri I plasticitetit: $W_p = 23 - 24\%$

Indeks i plasticitetit: $I_p = 11 - 12\%$

Klasifikimi

Simboli: CL

Emri grupit: Argjirore lymore

Pesha specifike ne gjendje te thate: 2.70 - 2.71 T/ m³

Pesha volumore e ngopur me ujë: 1.94 - 1.98 T/m³

Kënd i fërkimit: 18 - 220

Kohezioni: $C = 0.30 - 0.4 \text{ kg/cm}^2$

Moduli Elasticitetit: $e = 0,60 - 0.70$




Figura 1: Skema Gjeomorfologjike e bregdetit Adriatik dhe Jonian (a), dhe harta e trashesise se depozitimeve te Quaternarit ne gjirin e Durrësit (Burimi: Frasher, 2007)



Shtresa Nr. 5. Përfaqësohet nga argjila lymore ne ngjyre gri me lagështi, e bute, me përmbajtje shtresash te holla me rërë me trashësi 15 - 20cm. Ndeshet nen shtresën nr.4 ka një trashësi rreth 30m. Karakteristikat fiziko - mekanike te kësaj shtrese janë:

Përbërja granulometrike

Fraksioni 200:	60 - 82%
Fraksioni 40:	82 - 96%
Fraksioni 10:	100%
Përmbajtja e ujit:	$W_n = 30 - 34$
Kufiri I rrjedhshmërisë:	$W_I = 30 - 33\%$
Kufiri I plasticitetit:	$W_p = 21 - 23\%$
Indeksi plasticitetit:	$I_p = 9 - 10\%$

Klasifikimi

Simboli: CL - ML

Emri grupit: Argjile lymore

Pesha specifike ne gjendje te thate: 2.69 - 2.70 T/ m³

Pesha volumore e ngopur me ujë: 1.80 - 1.83 T/ m³

Kënd i fërkimit: 16 - 17°

Moduli Elasticitetit: $e = 0,85 - 0,9$

1.1.2 Rreziku Sizmik

Vendi ynë bën pjese ne brezin sizmik Alpin-Mesdhetar, i cili është nder me aktivet ne bote dhe karakterizohet nga tërmete te vegjël ($3.0 < M < 7.0$).

Ne raportin e projektit te zbatimit te Terminalit te Trageteve është marre ne konsiderate edhe sizmiciteti. Akselerimi horizontal maksimal i truallit gjate tërmetit është marre me 0.26g. Kjo shifër është bazuar ne Kategorinë 3 te argjilave dhe ne shkallen VIII balle. Ngarkesat sizmike duhet te përcaktohen përgjithësisht ne pajtim me UBC 1997 Kushtet e Projektimit ne Tërmete. Ne figurën 2 jepet linja geoelektrike ne zonën Durrës - Bishti i Pallës.






Figura 2: Vija Geoelektrike në zonën Durrës- Bishti i Pallës. (Burimi: Frashëri, 2007)

2. PERSHKRIM I PERGJITHSHEM I MJEDISIT BIOLOGJIK

2.1 MBULESA BIMORE NË VEND-ZBATIMIN E PROJEKTIT

Te dhënat kryesore mbi prezencën e specieve të Florës dhe Faunës detare janë marre nga Master Plani i Portit të Durrësit, dhe nga studimi i realizuar nga HPC Hamburg Port Consulting GmbH.

Ne këto studime kampionet biologjike ishin fokusuar në afërsi të zonës ku do të bëhej thellimi (p.sh. Baseni i Portit dhe kanali i hyrjes), vendi i zakonshëm ku derdhej materiali dhe pjesa lindore e kalatës përëndimore.

- *Phytoplankton*. Sasia me e madhe e phytoplanktoneve është identifikuar në vend depozitimit historik (3.7 km nga porti) dhe zona e kanalit të hyrjes, dhe sasia me e vogël është dalluar në zonën e basenit të portit.
- *Zooplankton*. Bashkësia e zooplanktoneve është e përbërë nga 23 taxons. Popullsia e përgjithshme e zooplanktoneve dhe diversiteti i tyre është parë në det të hapur (p.sh. vendi historik i depozitimit të materialit) me shumë se në buze të detit.



- *Peshqit*. Peshqit janë te llojeve te ndryshme ne gjirin e Durrësit dhe zona është e pasur me molusqe qe janë veçanërisht te një rëndësie ekonomike.

Persa i përket faunës ne fund te detit, janë marre 12 kampione dhe një video nënujore e cila përshkruan këtë habitat.

- Brenda kanalit te hyrjes fundi i detit është uniform (me sedimente homogjene te rërës) dhe kryesisht pa vegjetacion. Fauna e fundit te detit është shume e varfër ku gjithsej janë identifikuar 19 specie.
- Brenda zonës se skolierave lindore dhe perëndimore, fundi i detit karakterizohet nga rëra dhe sedimente qe përmbajnë ne mënyrë te konsiderueshme alga te kuqe. Numri i larte i specieve, 75, është identifikuar ne zonën e skolierës lindore.

Grupi dominant ishin molusqet. Ne zonën perëndimore sedimentet ishin pjesërisht te mbuluara nga algat jeshile. Janë verifikuar gati 74 specie ne zonën e skolierës perëndimore. Molusqet përsëri janë dominantë.

- Ne zonën e depozitimeve, fundi i detit përbehet nga rëra me granite dhe sedimentet janë te mbuluara nga alga jeshile. Ne disa pjese fundi i detit përbehej nga disa nënshtresa te forta. Ne këtë zone janë identifikuar rreth 71 specie. Përbërja e specieve është e njëjtë me zonën e skolierës lindore.

2.2 BURIMET UJORE

Projekti zhvillohet ne një port detar, por nëse i referohemi ujerave te pijshëm, ne zonën e projektit (basenit, kanalit hyrës dhe atë depozitimeve) nuk janë identifikuar burime ujore te kësaj natyre

3. NDIKIMET E MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDIS

Projekti i paraqitur nga "Zhvilluesi" ne Portin e Durrësit mund te ketë një ndikim shume te vogël, ose te paperfillshem ne topografinë lokale. Vendi i përzgjedhur për këtë veprimtari, me karakteristikat e tij te tanishme nuk pritet te ketë ndonjë ndikim qe mund te çojë ne përkeqësimin e kushteve sociale dhe ekonomike për komunitetin. Zhvillimi i portit do te ketë një ndikim te dobishëm socio-ekonomik, duke siguruar punësim te mëtejshëm.



3.1 NDIKIMET NË ORGANIZMAT DETARE

Studimet e ndryshme biologjike kane treguar se punimet e propozuara te thellimit te basenit dhe kanalit hyrës do te kenë një ndikim fare te vogël ne mjedisin detar ose mund te mos kenë fare. Komunitetet bentike janë te pakta, madje edhe ne stacionit e fundit qe shtrihet jashtë zonës e cila është thelluar me përpara. Megjithatë, operacionet e thellimit mund te largojnë kafshët qe jetojnë ne dhe nen sedimente. Nga rishikimi te dhënave te grumbulluara lidhur me efektet e operacioneve te thellimit ne zonat bregdetare ka treguar ne mbare boten tregon qe këto zona ne përgjithësi ri-kolonizohen. Normat e ri- kolonizimit te komuniteteve bentike pas pastrimit varion midis katër jave dhe 18 muaj.

3.2 NDIKIMET NË CILËSINË E UJIT

Pastrimi ka potencialin për te ndikuar ne cilësinë e ujit me shkaktimin e turbullirave, duke bere ri-mobilizimin e ndotësve nga sedimentet. Ne vendin e projektit, vëmendje e veçante duhet t'i kushtohet Kromit dhe Nikelit. Ri-mobilizimi i ndotësve varet shume nga metoda e thellimit (pastrimi). Për te shmangur turbullirat, rekomandohet te ndalohet "overflow" (presionet ose sasitë e mëdha te ujit) kur përdoret Suction Hopper Dredger.

3.2.1 Ndikimi i Turbullimit te Ujit ne gjallesat detare

Veçanërisht aktiviteti i thellimit mund te sjelle një shqetësim ose zhdukje te gjallesave ne basenin e portit dhe ne zonat përreth.

Turbullimi i ujërave është i pritshëm dhe i pashmangshëm gjate procesit te thellimit. Megjithatë, qëndrimi pezull i llumrave ne kolonën e ujit dhe shpërndarja e sedimenteve te tilla mund te minimizohet nëpërmjet zgjedhjes se metodës se përshtatshme te thellimit dhe pajisjeve te përshtatshme për thellim, si dhe nëpërmjet një kontrolli inxhinjerik gjate thellimit.

Pavarësisht nga impakti ambiental i mundshëm qe rezulton nga shpërndarja e materialit te thellimit, mund te jete e pranueshme vetëm për një kohe te shkurtër. Shpërndarja e materialit gjate thellimit ne det te hapur mund te shfarose gjallesat e fundit te detit dhe te zvogëlojë diversitetin e këtyre organizmave ne zonën e mbuluar nga materiali i thellimit.

Pavarësisht nga ky impakt i menjëhershëm, ripërtëritja e mjedisit detar (rikolonizimi i jetës detare ne një nënshtresë te re dhe një migracion vertikal i organizmave ne depozitimet e reja te thellimit) zakonisht fillojnë pas disa ditësh deri ne një jave pas depozitimit përfundimtar te materialeve te thellimit. Për me tepër tendencat e ristabilizimit te mjedisit detar te mëparshëm shpesh shfaqen pas disa muajsh



3.3 NDOTJA AKUSTIKE

Punimet e gërmimit për thellimin e basenit dhe kanalit hyrës të Portit dhe depozitimi i sedimenteve sipas projektit të propozuar do shoqërohen me rritje të nivelit të zhurmave mbi atë aktual. Gjithsesi këto ndikime pritet të jenë minimale dhe për një periudhë shumë të kufizuar kohe.

3.4 NDIKIMET NË TURIZËM

Zona që do të thellohet qëndron në distancë të konsiderueshme në plazhet dhe infrastrukturën turistike. Megjithatë, është e rekomanduar që punimet e thellimit (pastrimit) të kryhen në sezonin e ulët dhe të përdorin pajisje pastrimi që prodhojnë pak turbullirë (shih me lart), në mënyrë që të mos ndikojnë negativisht në zhvillimin e turizmit.

3.5 NDIKIMET NË TRANSPORT

Projekti i Thellimit të basenit dhe kanalit hyrës ofron përfitime të konsiderueshme lidhur me thellimin e projektit. Sedimentimi ka reduktuar në mënyrë të rrezikshme thellësinë e kanalit hyrës duke rritur rrezikun që anijet të prekin fundin e detit. Me sedimentimin e vazhdueshëm, rritet edhe mundësia e aksidenteve me të mëdha detare që mund të çojnë në ndotjen e mjedisit. Thellimi i basenit të portit dhe kanalit hyrës do t'ju ofrojë siguri anijeve për manovrim dhe për akses në portin. Kjo patjetër do të ketë një ndikim të dobishëm.

Gjate punimeve të thellimit, prezenca e dragës mund të paraqesë pengesë për të anijeve dhe shkaktoje pështjellime veçanërisht me trafikun në port. Këto ndikime do të jenë vetëm përkohësisht.

3.6 SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS

Ndërtimi i objekteve dhe punimet infrastrukturore kanë potencialin që të kenë një ndikim të dyfishtë të drejtpërdrejtë negativ në cilësinë e ajrit. Ndikimi i parë është ndotja e ajrit e gjeneruar nga pajisjet e ndërtimit dhe të transportit. Ndikimi i dytë është nga pluhuri që vjen nga rruga dhe lëndet e para që mund të ruhen në vend. Te dy këto ndikime janë tejet minimale për projektin "Thellimi i Basenit dhe Kanalit Hyrës të Portit të Durrësit".

Edhe sasia e mbetjeve të ngurta që mund të gjenerohen gjate procesit të thellimit do të jetë minimale (përpos sasisë të materialit të gërmuar që do të thithet nga TSHD dhe do depozitohet në vendin e Depozitimit).



3.7 KOHËZGJATJA E NDIKIMEVE TË IDENTIFIKUARA

Ndikimet e lart-përmendura negative ne mjedis do te kenë një kohëzgjatje shume te shkurtër. Ndotja akustike do jete e kufizuar, ndërsa ndikimi me i madh do jete ne turbullirën e ujit. Por edhe kjo do përfundojë me realizimin e projektit.

Flora dhe fauna nen ujore pritet te ri-instalohet brenda një kohe te shkurtër.

3.8 SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMEVE TË MUNDSHME

Shtrirja hapësinore e ndikimeve te lart -përmendura negative ne mjedis është shume e kufizuar, kryesisht ne zonën: basen-kanal hyrës vend depozitimi. E tere zona është shume larg qendrave te banuara dhe nuk prek jetën sociale apo ekonomike te qytetit.

3.9 MUNDËSIA E REHABILITIMIT

Rehabilitimi do jete një proces qe do ndodhe ne kushte natyrore.

3.10 MASAT PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE

Ndikimet negative ne mjedis te projektit janë minimale dhe te kufizuara persa i përket shtrirjes hapësinore dhe kohore.

Kujdes duhet treguar për minimizimin e turbullirave gjate procesit te thithjes (gërmimit), transportit dhe depozitimit te sedimenteve. Nëse këto operacione kryhen me kujdes, edhe procesi i ri-kolonizimit te fund-detit do realizohet shume me shpejt

3.11 NDIKIMET NË MJEDISIN NDËRKUFITAR

Projekti nuk do ketë ndikimet negative ne mjedisin ndërkufitar. Baseni qe do thellohet është shume ne brendësi te vendit kurse "Vendi i ri i Depozitimit" te sedimenteve edhe pse është rreth 7 km nga porti është akoma shume ne brendësi te ujerave territoriale shqiptare pa asnjë ndikim ne ujerat ndërkombëtare.



4. REFERENCA

1. Abeshi, J., Ohaskali, I., Dervishi, I., Dimco, E., & Elmas Ilari, E. (2010). Accumulation of Cadmium And Chromium In Water and Biota In Durres Bay (ALBANIA). In *Natura Montenegrina* (Vol. 9, No. 3, pp. 761-771). Natural History Museum of Montenegro.
2. Akademia e Shkencave te Shqipërisë. (1984. Klima e Shqipërisë. Instituti i Hidrometeorologjisë, Tiranë
3. Aliaj, Sh., Baldassarre, G., & Shkupi, O.(2001). Quaternary subsidence zones in Albania: Some case studies. *Bull. Eng. Geo/. Env.* 59, pp. 313-318.
4. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (<http://asig.gov.al>)
5. Barie, A., Kuspilic, G., & Matijevic, S. (2002), Nutrient (N, P, Si) fluxes between marine sediments and water column in coastal and open Adriatic. *Hydrobiologia*, 475 / 476:151-159
6. Bridges, TS., Ellis S, Hayes D, Mount D, Nadeau SC, Palermo MR, Patmont C, Schroeder P (2008) The Four Rs of Environmental Dredging: Resuspension, Release, Residual, and Risk. US Army Corps of Engineers, Engineer Research and Development Center, Report No. ERDC/EL TR-08-4, Washington, DC, February 2008
7. Celso, V., Sabi, D., Baraj, S., & Cullaj, A. (1999). An assessment of heavy metal pollution in the sediments along the Albanian coast. *Air, Water and Soil Pollution*. 111: 235-250.
8. Dedej, Z., Kromidha, G., Dragoti, N. (2015) . Marine and Coastal Protected Areas in Albania. UNDP. 31pp.
9. Dinaj, V. D. (2013). Terrestrial Photogrammetry in Albania and Its Contribution in Geophysical Researches. In: 7th Congress of the Balkan Geophysical Society.
10. Dolenc, T., Faganeli, J., & Pirc, S. (1998). Major, minor and trace elements in surficial sediments from the open Adriatic Sea: A regional geochemical study, *Geo/. Croat.* 51(1): 59-73.
11. Frascchetti, S., Terlizzi, A., Guarnieri, G., Pizzolante, F., D'Ambrosio, P., Maiorano, P., Beqiraj, S., & Boero, F. (2011). Effect of unplanned development on marine biodiversity: a lesson from Albania Central Mediterranean Sea). *Journal of Coastal Research*, 105-115
12. Frasheri, A. (2007). Outlook on some result of marine geology and geophysics studies in the Albanian Adriatic Shelf. Faculty of Geology and Mining, Polytechnic University of Tirana, Albania.
13. Frasheri, A., et. al. (2004). *Atlas i Burimeve te Energjise Gjeotermale ne Shqiperi*. Universiteti Politeknik i Tiranës. (<http://itc.upt.al/nfra/projects/geothermal/AlbanianGeothermalAtlasSmall.pdf>)
14. HPC Hamburg Port Consulting GmbH (2010). Consultancy services for the realization of the dredging Project for the port basin and the entrance channel of Durres Port: Environmental Report. 60pp.
15. HPC Hamburg Port Consulting GmbH (2010). Consultancy services for the



realization of the dredging Project for the port basin and the entrance channel of Durres Port: Chemical Analysis

16. HPC Hamburg Port Consulting GmbH (2010). Consultancy services for the realization of the dredging Project for the port basin and the entrance channel of Durres Port: Geological Survey Report

17 . HPC Hamburg Port Consulting GmbH (2010). Consultancy services for the realization of the dredging Project for the port basin and the entrance channel of Durres Port: Heavy Metal Analysis

18. HPC Hamburg Port Consulting GmbH (2010). Consultancy services for the realization of the dredging Project for the port basin and the entrance channel of Durres Port: Laboratory Analyses Report

19. HPC Hamburg Port Consulting GmbH (2010). Consultancy services for the realization of the dredging Project for the port basin and the entrance channel of Durres Port: Physical Analysis Cores for the Basin and Entrance Channel of the Port of Durres

20. HPC Hamburg Port Consulting GmbH (2010). Consultancy services for the realization of the dredging Project for the port basin and the entrance channel of Durres Port: Physical Analysis of Sediments

21. Marini, M. (2008). Valutazione dell'impatto ambientale dell'ex sito industriale di porto romano (Durazzo): effetti sulle specie ittiche oggetto di pesca. *Accordo di cooperazione scientifica e tecnologica tra il governo della Repubblica Italiana ed il governo della Repubblica di Albania'. periodo 2005-2007, Ministero degli Affari Esteri, Direzione Generale per la promozione e la cooperazione culturale-CNR – Istituto di Scienze Marine, Ancona, Italy.*

22. Marini, M., Betti, M., Gra ti, F., Marconi, V., Mastrogiacomo, A. R., Polidori, P., & Sanxhaku, M. (2012). Evaluation of lindane diffusion along the southeastern Adriatic coastal strip (Mediterranean Sea): A case study in an Albanian industrial area. *Marine pollution bulletin*, 64(3), 472 -478 .

23. OSPAR (2004). Guidelines for the Management of Dredged Material. Document: 2004-08. OSPAR (2004b).

24. Pigorini, B. (1968). Sources and dispersion of recent sediments of the Adriatic Sea, *Mar. Geol.* 6: 187 - 229.

25 . Politikat sektoriale SKZHI 2014 - 2020, Repository i Politikave Publike, Shtetweb.org

26. Southall, B. L., Bowles, A. E., Ellison, W. T., Finn eran , J. J., Gentry , R. L., Greene Jr, C. R., Kastak, D., Ketten, DR., Miller, J H., Nachtigall, PE., Richardson, WJ ., Thomas, JA., & Richardson , W. J. (2008). Marine mammal noise-exposure criteria: initial scientific recommendations. *Bioacoustics*, 17(1-3), 273-275.

27. Spagnoli, F., Dell'Anno , A., De Marco, A., Dinelli, E., Fabiano, M., Gadaleta, M. V., Ianni, C., Loiacono, F., Man in i, E., Marini, M., Mongelli, G., Rampazzo, G., Rivaro, P., & Vezzulli, L. (20 10). Biogeochemistry, grain size and mineralogy of the central and southern Adriatic Sea sediments: a review. *Chemistry and Ecology*, 26(S1). 19-44.

28. Storelli, M. M., Giacomini-Stuffler, R., & Marcotrigiano, G. (2002). Mercury



accumulation and speciation in muscle tissue of different species of sharks from Mediterranean Sea, Italy. Bulletin of Environmental Contamination and Toxicology, 68(2), 201 -2 10 .

29. Streftaris, N., & Zenetos, A. (2006). Alien marine species in the Mediterranean- the 100 'Worst Invasives' and their impact. Mediterranean Marine Science, 7(1), 8 7-118.

30. Study/Adjustment of the Master Plan for Durres Port. Final Rep ort. EuropeAid 122348/C/SER/ AL. Approved by DCM No . 546 , dated 28.05.2009. Official Gazette of Republic of Albania, No. 81 / 1, dated 04.06.2009.

31. Sulstarova E., Koçiaj S. & Aliaj Sh. (1980). Rajonizimi sizmik i Shqipërisë. Shtypshkronja. "Mihal Duri" Tirane, Monografi, Arkivi Institutit te Sizmologjisë, p. 297 .





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 627 - www.moe.gov.al

Nr. 4988 Prot.

Tiranë, më 04.07.2013

Nr. identifikues 134

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. EDISON IMERI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Fatmir MEDIU



*E Vlerësime per Hartimin e Raportit
Ndryshimi i projektit me Mjedisin
Fato Fillekore
Thellimi Emergjent i Basesit dhe
konkret Hynës për Mjedisin
dt. 21.03.2013*





REPUBLIKA E SHqipërisë
 MINISTERIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
 QENDRA KOMBËTARE E RIZIMIT

LICENCE

Numri serial: LN-4874-04-2018
 NUIS/NIPT: L81603023A

Subjekti: GREEN EAGLE CONSULTING

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njesia Administrative nr.7, Rruga "Muhamet Gjollështa", Shqyptkronja Toena, Kati 2

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 10/04/2018

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe Vlerësimi i ndikimit në mjedis).

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

per qe po jeta me lot Hyras ne portim te

per qe po jeta me lot Hyras ne portim te

per qe po jeta me lot Hyras ne portim te

Nënshkrimi i sportelit

Adri Hoxha



filldhenore
pa kës filldhenore
konkret e emergjent duhet
11.05.2018
gmx

Kjo certifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërprenë detyrimi ligjor për të qenë person i tatueshëm.



REPUBLIKA E SHqipërisë
 Ministria e Financave dhe Ekonomisë
 Qendra Kombëtare e Biznesit

NUMRI SERIAL:
 SN-526484-03-18

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personit të tatueshëm:

GREEN EAGLE CONSULTING – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Statusi:

Aktiv

Me adresë kryesore:

Tirane, Tirane, Njësia Administrative nr.7, Rruga "Muhamet Gjollështa", Shtypshkronja Toena, Kati 2

I jepet ky numër identifikimi (NUIS):

L81603023A

Afati i veprimtarisë:

Nga: 29/03/2018 deri

DATA E REGJISTRIMIT

03/04/2018

DATA E LËSHIMIT

04-04-2018

SPORTELI I SHËRBIMIT:

*Le themelimit fazës fillestare
 The themelimit dhe punës
 E veprimtarisë për punë të përbashkët
 për punë të përbashkët
 M.03/03/2018
 dt. M.03/03/2018*



Kjo certifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshime të shprehshme ndajuar të plastifikohet dhe të hapet për të bërë ndryshime të tjera në të njëjtin person i tatueshëm.